



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së VI (Gjashtë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 29 Qershor 2018.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e VI (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 29 Qershor 2018, dhe atë:

1. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për parcelën kadastrave NR. 00648-0 në ZK në Kaçanik, për Ndërtimin e trotuarit të rrugës “Sali Bajra” dhe Hapësirës publike për gjelbërimin, pran Gjykatës Komunale dhe QPS në Kaçanik.
2. Vendimi për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet, 2019 – 2021;
3. Vendimi për Aprovimin e Programi Trevjeçarë i Banimit i Komunës së Kaçanikut për vitet; 2018-2021; dhe
4. Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për shpenzimet e zhvarrimit dhe transferimin e eshtrave të ish- luftëtarëve, Avdyl Dura dhe Ramë Beka.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 400 - 19336/18
Kaçanik, 29.06.2018

Në bazë të nenit 42.2(b) dhe (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008) në shqyrtimin e Draftit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kaçanikut për vitet, 2019 - 2021 të Qarkores Buxhetore të MF 2019/01- për procesin buxhetor për periudhën 3 vjeçare lidhur me KABK 2019-2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Qershor 2018, mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITET 2019 - 2021

1. Me këtë Vendim, APROVOHET Drafti Kornizë, më tekstin e mëtejshëm: **Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet, 2019 – 2021.**
2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet: 2019-2021, lëshohet në procedurë të Debatit publik më qytetarë.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi, Financa, dhe Zhvillim të zhvilloj procedurën e Debatit publik më qytetarë dhe më Ekzekutivin e Komunës dhe pas saj rezultatet e diskutimit publik t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës, më qëllim të finalizimit të Draftit Kornizë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut, për vitet 2019-2021, e hartuar nga Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, me numër të protokollit 01 Nr. 400-19336/18..

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

*01 - Nr. 104/01-19943/2018
Kaçanik, 29.06.2018*

Mbështetur në nenin 12.2 (d) lidhur me nenin 17 dhe 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/01-19943/18, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 29 Qershor 2018, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE BUXHETORE PËR SHPENZIMET E ZHVARRIMIT
DHE TRANSFERIMIN E ESHTRAVE TË ISH - LUFTËTARËVE,
AVDYL DURA DHE RAMË BEKA

1. Me këtë Vendim, lejohet ndarja e mjeteve financiare nga Buxheti i Komunës së Kaçanikut, në shumë 3.000€ (tremijë euro) për shpenzimet e zhvarrimit dhe transferimin e eshtrave të dy ish-luftëtarëve- veprimtarëve të çështjes kombëtare, Avdyl Dura dhe Ramë Beka.
2. Mjetet buxhetore nga pika 1. e këtij Vendimi, do të sigurohen nga Programi Buxhetor i Zyrës së Kryetarit të Komunës nga bilancet e pashpenzuara të vitit 2017 respektivisht nga të Hyrat vetanake të cilat janë bartur në vitin 2018.
3. Për zbatimin këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim të njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit;
3. Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike; dhe
4. Arkivi

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërsoli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01. Nr. 464/01-18714/18

Kaçanik, 29.06.2018

Në bazë të nenit 12, 14, 17 lidhur me nenin 18.1(a) të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2.4 dhe nën paragrafi 3.3.10 të Ligjit 03/L-139 -Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, si dhe Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit 03/L-139 -Për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 91), të nenit 6 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me, 29 Qershor 2018, mori këtë :

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PARCELËN KADASTRALE NR. 00648-0 PËR NDËRTIMIN E TROTUARIT TË RRUGËS “SALI BAJRA” DHE HAPËSIRËS PUBLIKE PËR GJELBËRIMIN PRAN GJYKATËS KOMUNALE DHE QENDRËS PËR PUNËS SOCIALE NË KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, Shpallet me interes të përgjithshëm publik –për interesa të Komunës së Kaçanikut, patundshmëria **Nr.00648-0** në Zonën Kadastrale Kaçanik me kulturë; ndërtesë (lokal afarist) në sipërfaqe **11 m²** sipas Certifikatës së pronësisë Nr. 941-18694/18 në emër të Dijamant (Bajrush) Shehu nga Kaçaniku.
2. Parcela Kadastrale si në pikën 1 të këtij Vendimi, është e paraparë të destinohet për interesin të veçantë publik të Komunës Kaçanik, për Ndërtimin e trotuarit të rrugës “ Sali Bajra” dhe Gjelbërimit e hapësirës publike dhe lidhur me këtë patundshmëri mund të filloj procedura e shpronësimit.
3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas dispozitave ligjore të ligjeve në fuqi, t'i zhvilloj procedurat e nevojshme të shpronësimit të patundshmërisë së përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë; Certifikata me Nr. të lëndës : 941-18694/18 e datës 02 Korrik 2018.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Urbanizimit Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit;
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 03-500/01-18704/2018
Kaçanik, 29.06.2018

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17. 1 (k) Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), në funksion të zbatimit të nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-164 për financimin e Programeve të Veçanta të Banimit (Gazeta Zyrtare Nr. 67/29 Mars 2019), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Projekt Programit Komunal Trevjeçarë Banimit 2018-2021 me numër të protokollit 01Nr. 03-500/01-18704/2018, propozuar nga Kryetari i Komunës prej datës 13.06.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 Qershor 2018, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇARË
TË BANIMIT 2018-2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Programi Trevjeçarë i Banimit i Komunës së Kaçanikut për vitet; 2018-2021, i regjistruar me Numër të protokollit 01Nr. 03/ 500-01-18704.
2. Në Programin e përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi janë përcaktuar: objektivat, veprimet që duhet të merren, prioritetet, treguesit e suksesit, mjetet e verifikimit, institucioni përgjegjës dhe ai mbështetës, afati kohor dhe burimet e financimit, me qëllim të realizimit të tij.
3. Programit Trevjeçarë i Banimit është hartuar nga Grupi punues i përcaktuar me Vendim të Kryetari ti Komunës, 01Nr. 104/02-11075/18 të datës 06.04.2018, i përmbledhur në gjithsej 32 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e Programit të përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës - MAPL, si dhe 7 ditë Publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevant;
3. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit;
4. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
5. Arkivi.

